

***LËVIZJET STUDENTORE TË VITEVE 1968, 1981, 1997 NË KOSOVË SIPAS
HISTORIOGRAFISË BOTËRORE***

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCAVE TË HISTORISË NË DEPARTAMENTIN E

HISTORISË

NGA

BLERINA KASTRATI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

NENTOR, 2023

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

Mentorja: *Prof.Ass.Dr Albina Drançolli Ramadani*

Kandidatja: *Blerina Kastrati*

Tema: *Lëvizjet Studentore të viteve 1968, 1981, 1997 në Kosovë sipas Historiografisë Botërore*

Qëllimi i kësaj teze masteri është trajtimi i temës: " *Lëvizjet Studentore të viteve 1968, 1981, 1997 në Kosovë sipas Historiografisë Botërore,*". Për trajtimin e kësaj teme është bërë fillimisht grumbullimi i materialit adekuat ,më pas është bërë klasifikimi dhe analizimi i saj. Në kuadër të këtij punim janë katër kapituj.

Kapitulli i parë mban titullin *„Rrethanat socio-ekonomike në Kosovë gjatë viteve 1945-1998 në Historiografinë Botërore.* Pas përfundimit të luftës së Dytë Botërore Kosova aneksohet nga Serbia, dhe fillimisht në këtë kapitull është trajtuar statutit politik i Kosovës brenda Jugosllavisë nga viti 1945 deri në vitin 1998 duke u bazuar nga shkrimet e autorëve të huaj. Disa nga autorët e huaj që kanë analizuar e shkruar për statusin politik të Kosovës në këto vite janë; Marc Weller, Heike Kreinger, Noel Malcolm etj. Brenda këtij kapitulli po ashtu trajtohet një segment tjetër që janë rrethanat socio-ekonomike në Kosovë sipas këndvështrimit dhe elementeve që kanë marrë për studim brenda këtij konteksti. Disa nga elementet për të cilat shkruajnë, autorët e huaj si James Pettifer, Jenny Petterson, Carol Lily etj, janë: fillet e zhvillimit të prodhimit, politika shfrytëzuese e Serbisë ndaj ekonomisë së Kosovës, nataliteti, punësimi dhe migrimi.

Kapitulli i dytë mban titullin *„Lëvizja studentore e vitit 1968 në Kosovë në Historiografinë Botërore,*.. Në këtë kapitull janë trajtuar fillet e organizimi të lëvizjeve studentore në Evropë në vitet e '60 dhe impakti që kishin në lëvizjet studentore në Kosovë, shkaqet, kërkesat. organizimi i demonstratave të vitit 1968 dhe pasojat që kishin këto demonstrata. Në veçanti është trajtuar edhe themelimi i Universiteti të Prishtinës. Për të trajtuar këtë kapitull janë përdorur shkrime të studiuesve të huaj dhe atyre shqiptar, duke i vendosur në nivel krahasimtar. Disa nga këta autor që janë marrë për referencë janë: Martin Lipset, Philip Altbach, Tim Judah, Miranda Vickers, Sabile Keqmezi Basha, Aleskander Petrović etj.

Kapitulli i tretë mban titullin „ *Lëvizja studentore e vitit 1981 në Kosovë në Historiografinë Botërore*„. Në këtë kapitull janë trajtuar faktorët që kanë ndikuar në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, organizimin e tyre dhe karakterin e kërkesave që kishin shpalosur studentët. Segment tjetër që është trajtuar është edhe impakti i tyre në sensibilizimin e situatës së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe reagimin e shtypit ndërkombëtar ndaj demonstratave. Këto pika janë trajtuar duke analizuar këndvështrimin e disa prej historianëve të huaj si: Denis Hupchik, Bülent Ağır, Miranda Vickers, Hulm Sundhaussen, , Atdhe Hetemi, Vesna Pesic etj.

Kapitulli i katërt titullohet „*Aktivizmi studentor në vitet e '90 në Kosovë në Historiografinë Botërore*„. Vitet e '90 përbejnë një situatë të vështirë për Kosovën, dhe sidomos për arsimin shqip në Kosovë. Suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe largimi i mësimdhënësve dhe studentëve shqiptare nga puna, organizimi i sistemi arsimor paralel në Kosovë në të cilën shtëpitë u kthyen në shkolla e fakultete, dhe nisur nga kjo situatë organizimi i protestave të studentëve të vitit 1997 si shenjë pakënaqësie e rezistence janë pikat që janë trajtuar në këtë kapitull. Bujar Dugolli, Howard Clark, Denisa Kostovica, janë disa nga autorët që janë përdorur si pikë referencë për të trajtuar këtë pjesë.